



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 22/2015

Prishtinë, më 09.06.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha- Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti, dhe Duda Balje - anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK; David Greer, Ardian Kryeziu dhe Bardha Tahiri – USAID/CLE; Liridona Xhemajli –RTV21; Pranvera Musa -Kosovapress; Besa Berisha dhe Arta Xhylani – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02.06.2015;
3. Rekomandimet lidhur me "Kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata";
4. Shqyrtimi i Kërkesës për shtyrjen e afatit për shqyrtimin e Projektligjit Nr.05/L-27 për Dixhitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02.06.2015

Procesverbal i mbledhjes së mbajtur më 02.06.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Rekomandet lidhur me “Kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata”

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa- Tha së për këtë pikë të rendit të ditës, kemi debatuar disa herë, po ashtu kemi mbajtur një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Legjislacion, ku kanë qenë të ftuar: Këshilli Gjyqësor, Odat Ekonomike dhe Asociacionet e Bizneseve. Pastaj neve kemi pranuar disa raporte me shkrim, lidhur me problemet biznesore dhe adresimin e tyre në gjykata. Po ashtu kemi pranuar një analizë nga Programi i USAID-it për Përmbartim dhe Legjislacion Komercial, ku kjo është një analizë e funksionimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Ekonomike dhe në bazë të kësaj analize dhe në bazë të debatit kemi propozuar disa rekomandime të cilat i paraqiti si në vijim: 1. I rekomandohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që trajtimi i kontesteve biznesore në gjykata të shkurtohet në mënyrë radikale, duke shqyrtuar rastet më së largu brenda 6 (gjashtë) muajsh; 2. I rekomandohet Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Drejtësisë që të krijojë parakushtet e nevojshme buxhetore që më prioritet të bëhet konsolidimi i Departamentit për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Gjykatën e Apelit; 3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës të sigurojë buxhet për resurset e mjaftueshme për angazhimin e personelit mbështetës, duke rritur ndjeshëm numrin e gjyqëtarve në Departamentin për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Gjykatën e Apelit. Secili gjyqtar duhet të ketë në parim 1-2 bashkëpunëtorë profesionalë për të përgaditur rastet në mënyrë që të ngritet efektiviteti i punës; 4. Të bëhet e mundur botimi i "Buletinit të Rasteve Ekonomike" që gjyqtarët të kenë një qasje të lehtë në vendimet e kolegëve të tyre, gjë që në shumë raste rezulton me aktgjykime kundërthënëse në raste me fakte të ngjashme.

Ai theksoi se në kuadër të planit të punës së tij Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ndër çështjet më me prioritet ka marrë trajtimin e kushteve për një mjedis të përshtatshëm të të bërit biznes për investitorë të brendshëm dhe të jashtëm, stimulimi i prodhimeve vendore, krijimi i infrastrukturës ligjore dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve. Ai tha se zgjatja e shqyrtimit të kontesteve biznesore në gjykata mund të marrë edhe vite dhe kjo përbën një nga problemet më mëdha që ndikon negativisht në klimën biznesore dhe investuese. Lidhur me zbatimin e kontratave dhe ekzekutimit të tyre Kosova renditet në vendin 138, në listën e 189 vendeve në botë, kurse për zgjidhjen e problemeve të josolventitetit në vendin e 164 të dhëna nga Raporti Doing Business 2014. Kjo e bën të domosdoshëm rritjen e ndjeshme të efektivitetit të gjykatave në zgjidhjen e kontesteve biznesore brenda muajsh, të paktën në Gjykatën Themelore brenda 6 muajsh. Z. Mustafa, tha se kjo nuk është praktikë të dokumentohet nga rritja e numrit të rasteve të pazgjidhura nga 203 (viti 2008) në 885 (viti 2014). Andaj, kjo mund të jetë edhe pasojë e numrit të vogël të gjyqtarëve në departamentin përkatës numri i vogël i gjyqtarëve në Departamentin për çështje ekonomike. Ky numër viteve të fundit është sjellë midis 3-4 gjyqtarëve, e gjithashtu është joadekuat edhe numri i bashkëpunëtorëve profesionalë që mund të asistojnë gjykatësit në përgatitjen më të shpejtë dhe më cilësore të lëndëve. Prandaj në këtë situatë rritja e ndjeshme e numrit të gjykatësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në këtë Departament paraqitet si domosdoshmëri dhe njëra nga detyrat më urgjente për të adresuar lëndët e grumbulluara e të cilat mund të kenë ndikim esencial, si për situatën ekonomike e financiare në biznese të caktuara, ashtu edhe për klimën e biznesit në përgjithësi numri i gjyqtarëve për njëqindmijë (100.000) banorë duket të jetë dukshëm më i vogël se sa në vendet e tjera: Kosova -18,5; Bosnja e Hercegovina -25.1, Maqedoni 32.4; Sllovenia 47 gjyqtarë.

Duke e parë këtë situatë dhe reflektimin e saj tejet negativ në aktivitete biznesore janë ndërmarrë masa në bashkëpunimin me Komisionin për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për të dimensionet, shkaqet dhe pasojat që sjell ky problem. Ai tha se mbledhjen e përbashkët e dy Komisioneve është mbajtur më 05.05.2015, morën pjesë edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit. Diskutimet në mbledhjen e komisioneve u potencia se këto kontekste që zgjasin disa vjet patjetër duhet t'i sjellim në një kohëzgjatje prej disa muajve, përndryshe nuk mund të pretendohet që do të ketë një klimë të shëndoshë biznesi dhe nuk mund të pretendohet rritja e vëllimit të investime në Kosovë.

Fatmir Rexhepi- Tha se aktivitetin që ka bërë Komisioni lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata, është bërë një punë e mirë. Por kërkoi që të shtohet edhe një rekomandim që Komisioni për legjislacion dhe Komisioni jonë pra për zhvillim ekonomik, të mbikëqyrin se a po zbatohen këto rekomandime dhe të njoftohen të dy komisionet pas 6 (gjashtë) muajve apo një periudhe të caktuar se sa po zbatohen rekomandimet e cekura më lart.

Besim Beqaj- Tha se fillimisht është bërë një punë mirë që janë identifikuar këto probleme, që po përballën bizneset me këto konteste nëpër gjykata. Lidhur me rekomandimet tha që në parim pajtohet me to, por që duhet harmonizohen në aspektin teknike dhe gjuhësore për rekomandimin e 1 propozoi të fshihet fjala “radikale” dhe të gjendet një fjalë më përshtatshme dhe, të rekomandimi 2 fjala “konsolidimi” të ndryshohet me një termë më adekuat. Ndërsa për propozimin që rekomandimet të mbikëqyrin të bëhet “të njoftohet Komisioni pas 6 (gjashtë) muajve”.

Pal Lekaj- Tha që pajtohet që Komisionin ka bërë një punë të mirë që është marrë në mënyrë aktive me këtë çështje për t'iu mundësuar bizneseve një qasje më të lehtë në punët e tyre. Për rekomandimin 1 propozoi që të fshihet emërtimi që “t'i rekomandohet Këshilli Gjyqësor” dhe të zëvendësohet me emërtimin që “t'i rekomandohet Qeverisë”, pasi që edhe në aspektin e buxhetit që nevojitet për këto çështje është Qeveria ajo që merr vendim për ndarje të buxhetit dhe jo Këshilli Gjyqësor.

Raif Qela- Tha që pajtohet me të gjithë kolegët parafolës, që në këto rekomandime duhet bërë disa ndryshime të vogla të rekomandimi 1 fjala “radikale” të fshihet dhe për atë që të shtohet dhe një rekomandim për mbikëqyrjen. Për të gjitha këto sugjerime që u propozuan ai tha, që do t'i dërgojë edhe me shkrim.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa- Theksoi se pajtohet me këto propozime dhe para së të procedohen për seancë plenare këto rekomandime duhet të bëhet një renditje teknike dhe të lektorohen para shqyrtimit në seancën plenare. Kështu që debati me këto rekomandime mund të orientohet më qasjen më të mirë për të krijuar kushte dhe mundësi më të favorshme në të bërit biznes, qoftë për prodhuesit vendore dhe investitorët e jashtëm.

Pas debatit, Komisioni njëzëri miratoi këto:

Rekomandime:

1. I rekomandohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që trajtimi i kontesteve biznesore në gjykata të shkurtohet në mënyrë të ndjeshme, duke shqyrtuar rastet më së largu brenda 6 (gjashtë) muajsh;

2. I rekomandohet Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Drejtësisë që të krijojë parakushtet e nevojshme buxhetore që më prioritet të rritë kapacitetet e Departamentit për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Gjykatën e Apelit;
3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës të siguroj resurse të mjaftueshme për angazhimin e personelit mbështetës, duke rritur ndjeshëm numrin e gjyqëtarve në Departamentin për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Gjykatën e Apelit. I rekomandohet që secili gjyqtar në parim të ketë 1-2 bashkëpunëtorë profesionalë për të përgaditur rastet në mënyrë që të ngritet efektiviteti i punës;
4. Rekomandohet botimi i "Buletinit të Rasteve Ekonomike" që gjyqtarët të kenë një qasje të lehtë në vendimet e kolegëve të tyre, për të siguruar konsistencë në aktgjykime për raste të ngjashme;
5. Komisioni për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri dhe Komisioni për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, do të përcjellin zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe në afat prej 6 (gjashtë) muajsh do të informojnë Kuvendin për aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e tyre.

4. Shqyrtimi i Kërkesës për shtyrjen e afatit për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio -difuzeve tokësore

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa- Tha së për këtë pikë të rendit të ditës, kemi një kërkesë nga kryesuesit të grupit të punës, z. Raif Qela, për shtyrjen e afatit për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio- difuzeve tokësore.

Raif Qela- Tha duke marrë parasysh rrjedhat e punës së Grupit të punës, hulumtimin dhe studimin se si e kanë të rregulluar vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë ofrimin e shërbimeve digjitale mediave, si dhe kërkesat dhe reagimet e industrisë së mediave, Grupi i punës në mbledhjen e vet, të datës 5 qershor 2015 vendosi që të kërkojë prej Komisioni konkretisht Kuvendit, vazhdimin e afatit kohor për punën e tij edhe për 1 (një) muaj.

Komisioni e pranoi kërkesën e z. Qela, kryesuesit të grupit të punës, për shtyrjen e afatit për shqyrtimin për Digjitalizimin e transmetimeve radio- difuzeve tokësore për 1 (një) muaj bazuar në Rregullore të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa